



## Procesverbal 5/2023

I mbajtur në mbledhjen e 5-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e z.Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 26.05.2023 ne ora 09. 00.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Elaborimi i Rekomandimit të përgatitur dhe dorëzimi i saj.
5. Vizita në dy shkolla " Ahmet Hoxha" Ferizaj dhe " Naim Frashëri" Zaskok dhe
6. Të ndryshme.

**z.Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete** - Përshëndetje të pranishëm, këto janë pikat e rendit të ditës.

- Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete- të pranishëm janë të gjithë anëtarët, përveç znj. Silvana Maqak, që ka lajmëruar që do të vonohet në takim.

**z. Brahim Osmani** – Përshëndetje për të gjithë anëtarët e komitetit, kam një kërkesë për Planin e punës të Komitetit që të përcillet në Kuvendin e Komunës dhe të aprovohet.

**z.Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete-** A keni vërejtje për procesverbalin e fundit - Jo, faliminderit.

**z.Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete** – Njofton se janë dorëzuar Plani i punës i komitetit për komunitete tek Kryesuesi z. Xhavit Zariqi nëpërmjet Leutrimit që këtë Plan ta fusin në rend dite të KPF-së, po ashtu është dorëzuar rekomandimi me prioritetet të Lagjeve të vizituara nga Komiteti për komunitete tek Drejtoria e Infrastrukturës.

Dokumentin e keni përballë që kemi qenë në teren. A keni diçka me shtu para se me i dorëzuar rekomandimet drejtorive përkatëse.

- Vazhdojmë tek vizita sot në dy shkolla “ Ahmet Hoxha” dhe “Naim Frashëri” Zaskok.
- Vizita në shkollën “Ahmet Hoxha”.
- Prezentimi i anëtarëve.

**z. Buirimi** – Anëtari i ekipit për parandalimin për braktisje, shkolla e ka klasën shtesë.

**znj. Flora** - Cilat kanë qenë vështësit që i kanë braktisur dhe tek të cilat janë më shumë.

**z. Faruki** - 116 nënës kanë qenë: Ashkanli, Egjiptian, Rom, arsyja është kushtet, kryesisht Ashkali.

- Mësim plotësues janë 43 nxënës, janë prej komunitetit.

- Për parandalim kampanja.

**z.Burimi** - Keni pasur kanpanja për vetëdisim të parandalimit të braktisjes.

**z.Osman Eminit** - Kryesues i Komitetit për komunitete – Sa nxënës i ka shkolla, sa janë prej komuniteteve, sa është e pjesëmarrësve në sport, aktivitete kulturore?

**zv. Kryesuesi** – Janë 1004 nxënës, nuk bëhet asnjëherë diskutim për atë pjesë të komunitetit.

**Mësimdhënësi** – Në klasën e 9 të femrat e lënë shkollën, tentojnë në braktisje të shkollës për arsyë të krijimit të familjeve, arsyja, pse femrat e lënë shkollën?

**z. Bislimi** - A ka ndikim mbulesa në braktisjen e shkollës dhe a ka kësi raste për shkak të mbulesës – braktisje?

**z.Osman Eminit, Kryesues i Komitetit për komunitete** – Arsimtar a keni kësi raste të braktisjes në shkollë prej Viti 2022-2023?

**z.Burimi** - Kemi për momentin 5 nxënës që janë në proces për parandalim, dy në klasën e 9-të dhe 6-të, Familja Misini.

**z.Merita** - Ka qenë arsyja e divorcit, prindërit për braktisje të shkollës, janë tri motra në klasën e 6-të.

**Mësimdhënësi** - A keni raste që në teren keni hasur që ka pasur fëmijë në shtëpi dhe nuk është rexhistruar në shkollë hiç?

**z. Hajrizi** - Mungon vetëdisimi i prindërve, ne mundemi me shty fëmijët të ndjekin mësimin e jo t'i kem kushtet të rënda ekonomike, për me u arsimuar e jo për arsyë të kushteve.

**z. Burimi** – Ka pasë raste me probleme mendore, me problem me veshëmbathje tek nxënësit.

- Duhet të mirren masa ndëshkuese për prindër, mund të jetë si mjet për parandalim të shkollimit te nxënësit të komuniteteve.

- **Mësimdhënësi** - Kemi raste nëse ndalet sociali, atëherë e sjellin fëmijën në shkollë si e marrin socialin, atëherë e ndalin prej shkollës.

**z.Osman Eminit, Kryesues i Komitetit për komunitete** – Cila kishte me qenë masa ndëshkuese, për parandalimin e shkollimit.

- **z. Burimi** –

**Vazhdon vizita tek Shkolla “Naim Frashëri”.**


**Sa nxënës janë në shkollë, sa prej komuniteteve.**

**Drejtori** – Vështirësia më e madhe mosvijimi.

- Shumica në shkollë nga nxënësit e komuniteteve.

- Keni pasur një provë nëse 6-7 javë keni vijueshmëri në shkollë kemi me ju dërgu në Cineplex me shiku film.
- **Drejtori** – Kemi marr masa parandaluese, ulje e notës, sjelljes, kemi suspenduar një nxënës DKA ku është preferua të bëhet transfer nëpër shkolla tjera, por ajo nuk ka shku, sjellja e nxënësës me prindin që e kanë sulmuar mësimdhënësin, vitin e kaluar 2022.
- Në shkollën “Naim Frashëri” këtë vit kemi të llogaritur si braktisje 5 nxënës; 3 femra dhe 2 meshkuj.
- **zpj. Jehona Mustafa** – Sa nxënës nga komplet shkolla dhe sa prej tyre janë nxënës të komuniteteve?
- **Drejtori** – Shkolla ka 720 nxënës të bashkangjitur me klasët në Doganaj, 670 në shkollë “Naim Frashëri” dhe 50% të tyre janë nga komuniteti.
- **Drejtori** – Keni pengesa se nuk i lajmërojnë me kohë në rexhistratorin e klasës I .

Procesmbajtësja



Jehona Mustafa

Kryesuesi i Komitetit për komunitete



Osman Emini

